



Datë:
Numër Protokolli:

04.11.2025
7151/2025

A.nr.1734/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1734/2025, të datës, 24.09.2025, të parashtruar nga ankuesi V.K, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Mehdi Geci, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1734/2025, e datës 24.09.2025, e parashtruar nga ankuesi V.K.

A r s y e t i m

Ankuesi V.K (*tani e tutje referuar si ankuesi*), më datë 24.09.2025, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos veprimit (heshtjes administrative) të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në raport me kërkesën e ankuesit të datës 19.05.202 për anulim të njoftimit të datës 19.05.2025 dhe kompensimin e shpenzimeve shëndetësore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.10.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje vetëm MPJD), ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.10.2024, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit, ***është e pasafatshme, sepse:***

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë(Vlerësimi i gjendjes së çështje)

- Ankuesi është i punësuar në MPJD-së dhe se i njëjti ka ushtruar pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Viza.

- Sipas Vendimit Nr.464/2022, të datës 20.07.2022, të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi ishte caktuar të shërbej si Zëvendës Konsull në Ambasadën e Republikës së

Kosovës, e akredituar në Dhaka, Republika Popullore në Bangladesh, më një periudhë kohore katër vjeçar.

- Ankuesi, më datë 01.03.2024, ka parashtruar kërkesë tek Sekretar i Përgjithshëm i MPJD-së për aprovimin e shpenzimeve personale të trajtimit shëndetësor në spitalin privat në Bangladesh dhe atë në shumën e përgjithshme 2,200 Euro.

-Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së më datë 13.05.2024, ka nxjerr Vendim me Nr:Ref.206/2024, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e faturave të shpenzuara dhe dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, ndërsa, ky i fundit më datë 30.05.2024 ka përgatitur raportin për Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së me nr.prot: 2464, me konstatimi si vijon: *... Bazuar në Rregulloren Nr. 04/2023 për Kompensimin e Anëtarëve të Shërbimit të jashtme të Republikës së Kosovës, që ushtrojë jashtë vendit, konkretisht me nenin 10 kompensimi për sigurimin shëndetësor pika 1. Anëtarët të Shërbimit të Jashtë dhe pjesëtarëve të ngushtë të familjes së tyre të cilët jetojnë së bashku me anëtarin e shërbimit të jashtëm në vendin e punës u paguhet polica e sigurimit shëndetësor. Nga dokumentacioni i dorëzuar vërejmë se diplomati në fjale nuk ka sigurim shëndetësor në vendin e shërbimit dhe sipas sqarimit të tij nuk është tentuar të bëhet sigurimit shëndetësor për shkak citat: Me qëllim dhe vetëdije nuk kam lidhur sigurim shëndetësor pasi që e kam ndi veten me shëndet të mirë dhe nuk kam dashur të ngarkon arkën e shtetit në shumë rreth 7,000 euro në vit. Nga kjo vërejtëm se diplomati në fjale nuk ka shfrytëzuar me vetëdije të plotë këtë të drejtë që i takon sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu duke ju referuar nenit 7 të po kësaj rregulloreje ku thuhet se: Në vendet ku nuk mund të kontraktohet polica e sigurimit shëndetësor lejohet mbulimi i shpenzimeve të dokumentuara dhe të arsyeshme të kujdesit shëndetësor për shërbimet mjekësore që janë përcaktuar në shtojcën nr.3 të cilat miratohet nga shefi i misionit, ndërsa për shefin e misionit miratohen nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Ministrisë. Gjithashtu referuar dokumentacionit të dorëzuar vërejmë se nuk ka kërkesë paraprake të aprovuar nga Shefi i Misionit përkatësit ZKA, për mbulimin e shpenzimeve para fillimit të tretmanit mjekësor. Prandaj meqë të gjitha këto shpenzime janë kryer jashtë venit të shërbimit ne si komision rekomandojmë mos aprovimin e tyre..*

-Ankuesi, serish më datë 12.01.2025, ka parashtruar kërkesë të Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së gjegjësisht për aprovimin e shpenzimeve mjekësore të gjeneruara me rastin e trajtimit pranë dy klinikave private në Kosovë dhe Turqi, duke kërkuar aprovimin e shumës prej 7,519 Euro.

-Zyra e Sekretarit në MPJD, më datë 14.01.2025 ka njoftuar ankuesin se sipas rekomandimit të komisionit të formuar sipas vendimit të datës 13.05.2024, kërkesa juaj nuk aprovohet rekomandim për te cilën ankuesi nuk ishte njoftuar më parë.

- Pas tërheqjes së ankuesit nga mandati sipas Vendimit të ministres së MPJD të datës 31.01.2025, Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së më Vendimin Nr. ref. 81/2025 të datës 25.02.2025, ankuesin e ka sistemuar përkohësisht në pozitën Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore, ndërsa, më datë 19.05.2025 i është lëshuar Akt Emërimi Nr. 479/2025, po për pozitë të njëjtë, e të cilin akt emërim ankuesi e ka nënshkruar pa ndonjë vërejtje më datë 09.06.2025.

-Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij më autorizim më datë 19.05.2025, i është drejtuar serish Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së më kërkesë për anulimin e njoftimit të datës 30.05.2024 për refuzimin e kërkesës dhe aprovim të kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor pa specifikim të ndonjë vlere. Sipas shkresave të lëndës dhe thënieve në ankesë ankuesi nuk ka marr përgjigje në raport me këtë kërkesë.

- Më datë 29.08.2025 ankuesi i është drejtuar prapë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm më parashtrësë për shqyrtimin e kërkesës së datës 19.05.2025.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mos veprimit gjegjësisht heshtjes administrative të organit punëdhënës duke pretenduar së Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk është përgjigjur karshi kërkesave të adresuara. Me tej shton se Komisioni i cili ka shqyrtuar kërkesën për shpenzime ka tejkaluar kompetencat ligjore, ngase është thirrur në një rregullore që është shfuqizuar në vitin 2023 dhe po ashtu në kundërshtim me opinionin ligjor të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, të obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës/Sekretari i Përgjithshëm që të anuloi njoftimin e datës 30.05.2024 dhe të aprovojë kërkesat e ankuesit për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor sipas kërkesës së datës 12.01.2025.

Në kuptim të pranushmërsisë së ankesës, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nën punësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me theks të veçantë nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.....nenit 124 paragrafit 1 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe : 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet **jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ** dhe si rrjedhojë duke bazuar në këtë përcaktim ligjor si dhe duke qene së ankesa i referohet heshtjes administrative të MMPJD-së në raport me kërkesën e ankuesit të datës 19.05.2025, Kolegji konstaton së ankesa e ankuesit e ushtruar në Këshill më datë 24.09.2025, është parashtruar jashtë fatit ligjor për heshtje administrative, mbi arsyet se ankuesi më datë 19.05.2025 ka parashtruar ankesë për anulimin e njoftimit të datës 30.05.2024 dhe aprovimin e shpenzimeve shëndetësore, e duke qenë së i njëjti nuk kishte marr përgjigje nga organi punëdhënës brenda afatit prej 45 ditësh siç përshihet me 98 paragrafi 2 të LPPA, atëherë, ankuesi pas afati prej 7 ditësh nga skadimi i afatit 45 ditor, por jo më shumë se dy (2) muaj nga data kur MPJD-ja duhej të ofronte përgjigje në kërkesën e ankuesit të datës 19.05.2025, do të duhej të parashtronte ankesë në KPMSHCK për shkak të heshtjes administrative lidhur me kërkesën e datës 19.05.2025. Në fakt, MPJD-ja lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 19.05.2025, duhej të ofronte përgjigje deri më datë 03.07.2025, ndërsa, ankuesi 7 ditë pas këtij afati (11 korrik) dhe deri me 04 shtator 2025, mund të ushtronte ankesë për shkak të mosveprimit, rrjedhimisht heshtjes së MPJD-së ndërlidhur me këtë kërkesë.*

Kolegji i Këshillit rithekson faktin së ankuesi më datë 29.08.2025 ka parashtruar një parashtrësë të organi punëdhënës duke rikujtuar këtë të fundit më rrjedhën e procedurës në çështjen konkrete dhe detyrimet e MPJD-së sipas nenit 97 dhe 98 të LPPA-së, por që në vlerësimin e Kolegjit kjo parashtrësë po ashtu është e vonshme ligjërisht, pasi që në interpretim të dispozitave të nenit 127

paragrafi 1 dhe 4 të LPPA-së, ankuesi mund të parashtronte një parashtrësë të tillë vetëm brenda afatit 7 ditor nga data kur MPJD-ja duhet të ofronte përgjigje në kërkesën e ankuesit të datës 19.05.2025, dhe po ashtu në anën tjetër parashtrësja e datës 29.08.2025 po sikur të trajtohet si kërkesë e re e ankuesit, e njëjta konsiderohet e para afatshme, pasi që, MPJD në raport me këtë kërkesë duhet të përgjigjej në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës.

Andaj, bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së ankesa e ankuesit e datës 24.09.2025 është parashtruar në kundërshtim me afatin ligjor sipas nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 të LPPA-së dhe si e tillë konsiderohet e pranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”*

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.1734/2024, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankuesit që e njëjti serish të parashtroj kërkesë me bazë të njëjtë pranë organit të punësimit, e në rast të heshtjes se serishme administrative të këtij të fundit të ushtroj ankesë në Këshill brenda afateve ligjore për heshtje dhe çdo herë duke respektuar afatet e parashkrimit të kërkesave të natyrës materiale sipas ligjit në fuqi të punës.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1734/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Av. Mehdi Geci;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.